



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 291 Prot.

Tiranë, më 25/06/2026

URDHËR

Nr. 72, datë 25/06/2026

PËR

MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË
PËRBASHKËT NR. 108, DATË 15.06.2026 "PËR MIRATIMIN E KALENDARIT
PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027",
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2026 - 2027, me përbërje si më poshtë:
 - Prof. Asoc. Dorian Çene Zëvendësrektor
 - Znj. Adela Kusuri Përgjegjës, Sektori Juridik
 - Znj. Edlira Isak Specialist, Sektori Mësimor
2. Konkursat e pranimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të ofruara nga fakultetet e UART do të zhvillohen nga data 19 - 21 gusht 2026.
3. Administruesi i UART për sistemin e Portalit U – Albania, Përgjegjësi i Sektorit të IT-së, të marrë masa që në datën 04 gusht 2026, të shkarkojë nga Portali U-Albania listën e kandidatëve që do të konkurrojnë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të ofruara nga UART, t'i publikojë në faqen zyrtare të UART, sipas përcaktimeve ligjore si dhe t'ja dërgojë sekretarive mësimore të fakulteteve dhe Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.
4. Fakultetet, në datën 05 gusht 2026, të afishojnë në mjediset e fakulteteve listën e kandidatëve për konkursat e pranimit 2026 - 2027.

5. Regjistrimi i kandidatëve për konkurset e pranimit në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor do të bëhet pranë sekretarive mësimore të fakulteteve, duke filluar nga data 10 gusht 2026, nga ora 08:00 deri në orën 16:00.
6. Dokumentacioni për t'u regjistruar në konkurset e pranimit është:
 - Mandati i pagesës së tarifës së konkurrimit;
 - Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës.
7. Regjistrimi pranë sekretarive mësimore të fakulteteve të UART bëhet nga vetë konkurenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
8. Kanë të drejtë të regjistrohen në konkurset e pranimit të ciklit të parë Bachelor vetëm kandidatët sipas listës së shkarkuar nga portali U-Albania.
9. Të afishohen në mjediset e secilit nga fakultetet të UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkurset e pranimit të ciklin të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit, rregulloret dhe kriteret e transferimit të programit të studimit ose të konkurrimit në një program të dytë studimi, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme për këtë proces.
10. Strukturat përgjegjëse të secilit fakultet të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e konkurseve të pranimit si dhe ndjekjen me përgjegjësi të afateve të përcaktuara sipas etapave të zhvillimit të konkurseve dhe procedurave të regjistrimit të kandidatëve/studentëve deri në përcjelljen e tyre për numër matrikullimi në zbatim të kalendarit të Urdhrit të Përbashkët nr. 108, datë 15.06.2026 dhe të këtij Urdhri.
11. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e fakulteteve të UART, Administratori i UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, sekretarët mësimore të fakulteteve dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.
12. Të njoftohet për marrjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen e ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike Illyrian Guard sh.p.k.
13. Ky urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

